

# *Politika fiskale dhe rritja ekonomike: rasti i vendeve të Evropës Juglindore*

*Kadë Morina\**

## **Abstrakt**

Ky punim analizon efektet e politikës fiskale në rritjen ekonomike të vendeve të hapura e në zhvillim siç janë vendet e Evropës Juglindore. Diskutimi që lidhet me ndikimet e politikës fiskale në rritjen ekonomike është mjaft aktual, pasi zhvillimi i instrumenteve të duhura fiskale mund të çojë në rritje ekonomike të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të këtyre vendeve. Metodën të cilën e kam përdorur në këtë punim është modeli Panel data, përkatësisht Pooled OLS, Fixed Effects, Random Effects dhe Hausman Taylor-IV, për të vlerësuar ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike. Variablat e përdorura në këtë punim janë: GDP-rritja ekonomike, të ardhurat tatimore dhe shpenzimet qeveritare. Rezultatet e arritura tregojnë se politikat tatimore të qeverisë kanë ndikim më të madh në rritjen ekonomike se sa ato të shpenzimeve. Ndikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në rritjen ekonomike u analizua me të dhëna prej vitit 1994 deri 2015.

**Fjalë kyç:** *politikë fiskale, rritje ekonomike, të ardhura tatimore, shpenzime qeveritare, metodë Panel data.*

## **Hyrje**

Politika fiskale ka rol të madh në zhvillimin dhe rritjen ekonomike në vendet e Evropës Juglindore. Për këtë arsye, qëllimi i këtij punimi është të analizojë lidhjen e politikës fiskale me rritjen ekonomike në vendet me ekonomi të hapur e në

---

\* MSc. Kadë Morina, Universiteti "Haxhi Zeka"- Pejë.  
E-mail: kada\_morina@hotmail.com

zhvillim siç janë vendet e Evropës Juglindore, pasi është thelbësore dhe me interes të kuptojë se si aktiviteti publik, përmes politikave të tatimeve dhe shpenzimeve, ka shërbyer për të nxitur rritjen ekonomike. Financat publike përsuan reformime thelbësore dhe të vazhdueshme, duke pasur si qëllim uljen e shpenzimeve të qeverisë dhe rritjen e të ardhurave. Politikat fiskale janë përcaktuese të rëndësishme të zhvillimeve ekonomike. Shpesh, vendimet e qeverisë mbi shpenzimet dhe tatimet luajnë rol të veçantë për përsheptimin apo ngadalësimin e rritjes ekonomike. Kriza ekonomike dhe financiare bëri të rëndësishme stimulimin e politikës fiskale për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe rimëkëmbjen e rritjes ekonomike. Qeveritë në mbarë botën duhet të formulojnë dhe të zbatojnë politikat për tatimet dhe shpenzimet publike. Këto politika mund të kenë ndikime të mëdha në rritjen ekonomike, shpërndarjen e të ardhurave dhe varfërinë, dhe kështu ata kanë tendencën të jenë në qendër të debateve ekonomike dhe politike. Në këtë rast, pyetjet që ngrihen lidhen me analizën e ndikimeve konkrete të politikave fiskale në rritjen ekonomike, në rastin e vendeve të Evropës Juglindore? A e kanë nxitur ato rritjen ekonomike në këto vende? Ky hulumtim fokusohet në mënyrën se si përbërja e shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisë ndikon normën e rritjes afatgjatë. Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve është mjaft e vështirë sepse mekanizmat e funksionimit të transmetimit të efekteve të politikës fiskale janë mjaft të ndërlikuara dhe mbi të gjitha, efektet kërkojnë kohë që të shfaqen plotësisht. Për të kuptuar më mirë procesin e rritjes, ky studim zhvillon një model empirik duke përdorur një qasje të serive kohore për rastin specifik të vendeve të Evropës Juglindore. Kjo është përpjekje për të shqyrtuar politikën fiskale dhe ndikimin e saj në rritjen e qëndrueshme ekonomike në vendet e Evropës Juglindore. Pjesa tjetër e punimit është si më poshtë: seksioni II

përfshin rishikimin e literaturës, seksioni III shpjegon procedurën e modelit dhe mbledhjes së të dhënave, po ashtu përshkruan metodologjinë dhe seksioni IV paraqet rezultatet empirike. Në fund, seksioni V paraqet përfundimin dhe rekomandimet.

### ***Rishikimi i literaturës***

Roli i politikës fiskale në procesin e rritjes afatgjatë ka qenë qendror për makroekonominë, veçanërisht që nga shfaqja e modeleve të rritjes endogjene. Autorët e ndryshëm janë fokusuar në lloje të ndryshme të politikës fiskale si motorë të rritjes së ekuilibruar. Në këtë pjesë të punimit, do të analizoj evidencën empirike për ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike dhe do të bëj ndërlidhjen e punimit me mendimet e autorëve të tjerë. Në një studim autorët provojnë korrelacionin midis politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në Rumani, për periudhën 1990-2007. Modeli i korrelacionit midis normës reale të rritjes së PBB-së dhe kategorive të të ardhurave buxhetore tregon një lidhje të kauzalitetit negativ midis rritjes ekonomike dhe të ardhurave fiskale.<sup>1</sup> Autorët arrijnë në përfundimin se disa forma të politikave tatimore dhe atyre të shpenzimeve mund të nxisin ose të zvogëlojnë rritjen ekonomike.<sup>2</sup> Studimi i Benos analizon nëse një rishpërndarje e komponentëve të shpenzimeve publike dhe të ardhurave mund ta rrisë rritjen ekonomike duke përdorur të dhëna për 14 vendet e BE-së gjatë viteve 1990-2006. Rezultatet

---

<sup>1</sup> Laura Obreja-Brasoveanu & Iulian Brasoveanu, "The Correlation between Fiscal Policy and Economic Growth", *ResearchGate*.

<sup>2</sup> Richard Kneller, Michael F. Bleaney & Norman Gemmill, "Fiscal policy and growth: evidence from OECD countries", *Journal of Public Economics*, 74 1999.

ofrojnë mbështetje për modelet endogjene të rritjes.<sup>3</sup> Shqyrtuan ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike në varësi të kushteve institucionale në vendet e OECD-së gjatë periudhës 2000-2012. Analiza bazohet në metodat dhe testet e regresionit të paneleve.

Nga rezultatet e analizës është e qartë se në rastin e shpenzimeve qeveritare 1) ka ndikim pozitiv në rritjen ekonomike në vendet me transparencë më të ulët fiskale; 2) ka ndikim negativ në vendet me transparencë më të lartë fiskale. Në vendet më pak të zhvilluara ka përqindje më të lartë të shpenzimeve pro-rritje brenda shpenzimeve totale të qeverisë. Në rastin e impaktit tatimor në rritjen ekonomike është e dukshme që (3) ndikimi negativ i taksimit është më i dëmshëm për rritjen ekonomike në vendet me kushte më të këqija institucionale. Shpjegimi i këtij rezultati mund të lidhet me transparencën e ndryshme fiskale dhe me nivelin e ndryshëm ekonomik.<sup>4</sup> Autorët vlerësuan efektin afatgjatë të politikës fiskale në aktivitetin real ekonomik në ekonominë e vogël të tranzicionit të hapur: rastin e Republikës së Maqedonisë. Rezultati tregon se ekzistojnë dy vektorë kointegrimi statistikisht të rëndësishëm. Vektori i parë i kointegrimit tregon se një rritje e shpenzimeve të qeverisë do të gjenerojë efekt pozitiv në aktivitetin ekonomik real. Vektori i dytë i kointegrimit tregon se një rritje e shpenzimeve qeveritare do të gjenerojë efekt pozitiv në të ardhurat e qeverisë.<sup>5</sup> Analizojnë efektin e politikës fiskale

---

<sup>3</sup> Nikos Benos, "Fiscal policy and economic growth: empirical evidence from EU countries", *MPRA Paper*, No. 19174, posted 11. December 2009.

<sup>4</sup> Rudolf Macek & Jan Janků, "The impact of fiscal policy on economic growth depending on institutional conditions" 2015.

<sup>5</sup> Besnik Fetaj & Selajdin Abduli, "Fiscal Policy and Real Economic Activity in a Small Open Transition Economy (The Republic of Macedonia): Cointegration Model". In *International Journal of Scientific Publications: Economics & Business*, Vol. 7, issue 1, Info Invest Ltd, Sofia, Bulgaria, 9 / 2013. ISBN 1313-2555.

në prodhim dhe tregojnë një reagim standard të Keynesianit të ekonomisë për të dy llojet e goditjeve: një rritje e taksimit ka efekte negative në prodhim dhe konsum, ndërsa rritjet pozitive në shpenzimet publike sjellin efekte pozitive mbi këto variabla.<sup>6</sup> Sipas autorëve të cilët analizuan efektet e politikës fiskale në Shqipëri në rritjen ekonomike, bazuar në një model endogjen të politikës në rritjen ekonomike. Lidhur me variablat fiskalë, rezultatet e arritura tregojnë se norma e përgjithshme e rritjes ekonomike ndikohet negativisht nga të ardhurat e qeverisë dhe pozitivisht nga politikat për shpenzimet qeveritare.<sup>7</sup>

### ***Të dhënat dhe metodologjia***

Për të shqyrtuar lidhjen ndërmjet politikës fiskale dhe rritjes ekonomike, do të aplikoj metodën Panel data përkatësisht Pooled OLS, Fixed Effects, Random Effects dhe Hausman Taylor-IV. Me këto metoda unë jam në gjendje për të vlerësuar ndikimin e politikës fiskale në rritjen ekonomike në vendet e Evropës Juglindore nga viti 1995-2015. Kam përdorur të dhënat vjetore të marra nga Banka Botërore që mbulojnë periudhën 20-vjeçare. Në mënyrë që të merrem me problemin e endogjenitetit, kam përdorur variablat instrumentale. Hausman-Taylor variablat instrumentale IV është konsideruar të jetë modeli më i përshtatshëm se sa modelet e efekteve të rastit dhe efekteve fikse. Variabli i varur është GDP-ja për frymë - rritja ekonomike, ndërsa variablat e pavarura janë shpenzimet qeveritare dhe të ardhurat nga tatimet.

---

<sup>6</sup> Olivier Blanchard & Roberto Perotti, "An Empirical Characterization of the Dynamic Effects of Changes in Government Spending and Taxes on Output", *Quarterly Journal of Economics*, No. 117, 2002.

<sup>7</sup> Gerti Shijaku & Arlind Gjokuta, "Politika fiskale dhe rritja ekonomike: Rasti i Shqipërisë", Material diskutimi, Banka e Shqipërisë, 04 (63) 2013.

$$y_{it} = c + \beta_1(y_{it-1}) + \beta_2(\text{Tax revenue}) + \beta_3 (\text{Government expenditure}_{it}) + u_{it} \quad (1)$$

ku:  $y_{it}$ - paraqet rritjen ekonomike (GDP)

$c$  - paraqet një konstantë

$y_{it-1}$  - paraqet "First Lag<sup>8</sup>" të GDP-së

**Government expenditure<sub>it</sub>** - paraqet shpenzimet qeveritare.

**Tax revenue<sub>it</sub>** - paraqet të ardhurat tatimore.

$u_{it}$ -paraqesin efektet e jashtme (exogenous disturbances).

## Rezultatet empirike

Tabela 1. Tregon rezultatet e koeficienteve të regresionit dhe të gjithë koeficientet janë statistikisht të rëndësishme. Siç shihet nga tabela 1, rezultatet e koeficientit të regresit të të ardhurave tatimore janë 0.0461881 (s.e 0.2142978), pra statistikisht të rëndësishme. Kjo tregon se një rritje prej 1% e të ardhurave tatimore do të ketë një efekt pozitiv në rritjen ekonomike prej 0.04%, duke mbajtur konstante variablat tjera. Ky rezultat është në përputhje me studimet e mëparshme, siç janë: Kneller dhe të tjerët (1999) dhe Benos (2009). Roli i të ardhurave tatimore në rritjen ekonomike varet shumë nga politika e zbatuar makroekonomike, pra sipas rezultatit të ardhurat tatimore kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike në vendet e Evropës Juglindore. Rritja e të ardhurave mbështeti bilancin fiskal të rajonit. Sipas Bankës Botërore raporti mesatar i të ardhurave ndaj PBB-së për Ballkanin Perëndimor u rrit nga 34.8 për qind e PBB-së rajonale në vitin 2015 në 35.8 për qind në 2016. Pavarësisht mobilizimit më të mirë të të ardhurave, mungesa e efikasitetit në mbledhjen e taksave, përhapja e përjashtimeve tatimore dhe për të huajt vijojnë të përbëjnë probleme madhore për politikën fiskale. Reduktimi i përjashtimeve nga taksat do të bënte që të ardhurat e mëparshme të pambledhura të shkojnë sërish në buxhetet e shumicës së vendeve të Ballkanit Perëndimor.

---

<sup>8</sup> Ky term i takon analizës statistikore të të dhënave të serive kohore ku modelet ndonjëherë ndërtohen, në të cilat një variabël parashikohet duke u bazuar në vlerat e kaluara të saj.

Variabli tjetër i politikës fiskale i përfshirë në këtë hulumtim është variabli i shpenzimeve qeveritare. Rezultati tregon se koeficienti i shpenzimeve qeveritare është  $-0.0793733$  (s.e  $0.1548039$ ), që do të thotë me rritjen e shpenzimeve qeveritare për 1 % do të ndikojë në uljen e rritjes ekonomike për 0.15%, duke mbajtur variablat tjera konstant. Në mënyrë që shpenzimet qeveritare të kenë ndikim në rritjen ekonomike duhet që të ndërmerren reforma strukturore për orientimin e shpenzimeve qeveritare në sektorë që kanë potencial në rritjen ekonomike të një vendi. Shumica e vendeve ngadalësuan ritmin e rritjes së shpenzimeve, por shkurtimi i shpenzimeve u fokusua në investimet kapitale.

*Tabela 1. Rezultatet nga modelet Pooled OLS, Fixed effects, Random effects dhe Hausman Taylor*

	<b>Pooled OLS</b>	<b>Fixed effects</b>	<b>Random effects</b>	<b>Hausman Taylor IV</b>
<b>Variablat</b>	<b>GDP</b>	<b>GDP</b>	<b>GDP</b>	<b>GDP</b>
<b>Gdplag1</b>	.3161526** .1378168	.3058253** .14381	.3161526** .1378168	.3096811** .1396705
<b>Tax revenue</b>	.0247872* .2081887	.0167035* .2661385	.0247872* .2081887	.0461881* .2142978
<b>Government expenditure</b>	-.0627713* .1430121	.0409208* .3094175	-.0627713* .1430121	-.0793733* .1548039
<b>Constant</b>	2.385874* 3.657157	.7038022* 7.502987	2.385874* 3.657157	2.423861* 3.703917
<b>Observations</b>	64	64	64	64
<b>R-squared</b>	0.1002	0.0886		
<b>F</b>	2.23	1.51		
<b>Chi2</b>			6.68	6.73
<b>Model</b>	OLS	Fe	Re	-
<b>Comand</b>	Regress	Xtreg	Xtreg	Xthttaylor
<b>Number of ID</b>	-	7	7	7

*Shënim: (\*) statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5%, (\*\*) statistikisht i rëndësishëm në nivelin 10%*

## ***Përfundim***

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizojë empirikisht lidhjen në mes të politikës fiskale dhe rritjes ekonomike në vendet e Evropës Juglindore. Bazuar në rezultatet empirike mund të konstatoj se të ardhurat tatimore kanë ndikim pozitiv në rritjen ekonomike, ndërsa shpenzimet qeveritare kanë ndikim negativ në rritjen ekonomike në vendet e Evropës Juglindore.

Në përfundim, hartimi i kujdesshëm dhe zbatimi i duhur i rregullave fiskale mund t'i ndihmojë vendet e Evropës Juglindore të garantojnë aftësinë paguese dhe qëndrueshmërinë e borxhit. Instrumentet e politikave që inkurajojnë qëndrueshmërinë fiskale, siç janë rregullat fiskale, kanë tërhequr vëmendjen e vendeve të tjera që kanë nevojë për konsolidim fiskal. Një nga objektivat themelore të rregullave fiskale është rritja e besueshmërisë së politikës fiskale si bazë për rritjen ekonomike. Politika fiskale konsiston në përdorimin e të ardhurave tatimore dhe shpenzimeve qeveritare si mjete për të ndikuar në treguesit makroekonomik të një vendi. Shpenzimet qeveritare ndikojnë në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve në ekonomi, pra edhe në nivelin e GDP-së e për rrjedhojë edhe në nivelin e punësimit, inflacionit etj. Politika fiskale ndikon drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në ekonominë e vendit. Nëse nivelet e shpenzimeve qeveritare ndjekin rrugën e tyre të tanishme, do të ishte shumë e vështirë për vendet e Evropës Juglindore të ruajnë një rrugë afatgjatë të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.



## **Bibliografia**

Blanchard, Olivier & Perotti, Roberto. "An Empirical Characterization of the Dynamic Effects of Changes in Government Spending and Taxes on Output". *Quarterly Journal of Economics*, No. 117. 2002. f. 1329-1368.

Benos, Nikos. "Fiscal policy and economic growth: empirical evidence from EU countries". *MPRA Paper*, No. 19174, posted 11. December 2009. f. 1-31.

Fetai, Besnik & Abduli, Selajdin. "Fiscal Policy and Real Economic Activity in a Small Open Transition Economy (The Republic of Macedonia): Cointegration Model". *In International Journal of Scientific Publications: Economics & Business*, Vol. 7, issue 1, Info Invest Ltd, Sofia, Bulgaria. ISBN 1313-2555. 9 / 2013. f. 136-144.

Kneller, Richard. Bleaney, Michael F. & Gemmell, Norman. "Fiscal policy and growth: evidence from OECD countries". *Journal of Public Economics*, 74 (1999). f. 171-190.

Macek, Rudolf & Janků, Jan. "The impact of fiscal policy on economic growth depending on institutional conditions". 2015. f. 95-107.

Obreja-Brasoveanu, Laura & Brasoveanu, Iulian. "The Correlation between Fiscal Policy and Economic Growth". *ResearchGate*. July 2008. f. 19-26.

Shijaku, Gerti & Gjokuta, Arlind. "Politika fiskale dhe rritja ekonomike: Rasti i Shqipërisë". Material diskutimi, Banka e Shqipërisë, 04 (63) 2013. f. 1-32.

The World Bank, "Fiscal policy and economic growth" Washington, DC, ISBN: 0-8213-7181-9. 2007. f. 1-331.

World Bank Group, Ballkani Perëndimor Raport i rregullt ekonomik nr. 11, "Rritje më e shpejtë ekonomike, më shumë punësim". Pranverë 2017. f. 1-70.

## APPENDIX

### Hausman Taylor

```
. xhtaylor gdp gdplag1 taxrevenuegdp governmentexpendituregdp code, endog(governmentexpendituregdp)

Hausman-Taylor estimation                Number of obs   =       64
Group variable: code                    Number of groups =        6

                                         Obs per group: min =        6
                                         avg =          10.7
                                         max =          18

Random effects u_i ~ i.i.d.             Wald chi2(4)    =        6.73
                                         Prob > chi2     =       0.1511
```

gdp	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]
TVexogenous					
gdplag1	.3096811	.1396705	2.22	0.027	.0359319 .5834304
taxrevenue-p	.0461881	.2142978	0.22	0.829	-.3738279 .4662041
TVendogenous					
government-p	-.0793733	.1548039	-0.51	0.608	-.3827834 .2240368
TIexogenous					
code	-.040872	.2905478	-0.14	0.888	-.6103353 .5285914
_cons	2.423861	3.703917	0.65	0.513	-4.835682 9.683404
sigma_u	0				
sigma_e	3.5725104				
rho	0	(fraction of variance due to u_i)			

Note: TV refers to time varying; TI refers to time invariant.